

VENDIM
Nr.550, datë 7.7.2010

**PËR DHËNIE FONDI FINANCIAR SHITESË KOMUNAVE QUKËS E QENDËR
LIBRAZHD, TË QARKUT TË ELBASANIT, PËR T'U SHPËRNDARË NË NDIHMË TË
FAMILJEVE TË KËTYRE KOMUNAVE, PËR SHKAK TË DËMTIMIT TË BANESAVE
TË TYRE NGA FATKEQËSI TË NDRYSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” dhe të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunave Qukës e Qendër Librazhd të qarkut të Elbasanit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’u jepet fond financiar shitesë, për t’u shpërndarë në ndihmë të familjeve të këtyre komunave, për shkak të dëmtimit të banesave të tyre nga fatkeqësi të ndryshme, si më poshtë vijon:

a) Komunës Qukës, 10 900 000 (dhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekë.

b) Komunës Qendër Librazhd, 7 700 000 (shtatë milionë e shtatëqind mijë) lekë.

2. Fondet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij vendimi, t’u shpërndahen familjeve sipas listës me emrat e kryefamiljarëve, të hartuar për secilën komunë, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Fondi i përgjithshëm, 18 600 000 (tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut të Elbasanit, këshilli i qarkut të Elbasanit dhe komunat Qukës e Qendër Librazhd për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

**LISTAT ME EMRAT E KRYEFAMILJARËVE, PËR SECILËN KOMUNË TË QARKUT
ELBASAN, TË CILËT PËRFITOJNË NDIHMË FINANCIARE, SIPAS KËTIJ VENDIMI**

Komuna Qukës

N r	Emër, atësi, mbiemër	Ndihma 000/lekë
1	Liman Muharrem Dashballa	1100
2	Shahe Nuredin Dashballa	1100
3	Ilia Hekuran Dashballa	1000
4	Vasil Shaban Zharri	1200
5	Pandeli Shaban Zharri	1000
6	Lushe Isuf Zharri	600
7	Hajdar Sejfulla Radiçi	500
8	Isa Xhaferr Belba	300
9	Xhevdet Ferik Belba	1100
10	Luze Qazim Omeri	600
11	Makbule Dule Zeneli	600

1 2	Avni Halil Polisi	600
1 3	Bajame Hysen Pjetri	700
1 4	Aqif Nazmi Liçi	500
	Shuma	10900

Komuna Qendër Librazhd

N r	Emër, atësi, mbiemër	Ndihma 000/lekë
1	Agim Koka	1100
2	Limon Alla	700
3	Hasan Alla	1000
4	Petrit Alla	1000
5	Viktor Alla	700
6	Fatmir Dosku	700
7	Rasim Alla	800
8	Naim Alla	800
9	Agron Dosku	900
	Shuma	7700